



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 24

Prishtinë, më 19.4.2018, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Albulena Haxhiu, Hajdar Beqa, Bahrim Shabani, Sami Kurteshi, Arben Gashi, Shkumbin Demaliaj dhe Bilall Sherifi.

Munguan: Glauk Konjufca, Korab Sejdiu, Nezir Çoçaj dhe Igor Simiq.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Drilon Krasniqi dhe Rinor Dervishaj, student të Fakultetit Juridik; Ardiana Hajzeri, Radio Kosova; Valbona Bytyçi, Ekonomia Online; Ardi Shita dhe Hasie Abdullahu, USAID; Burim H. Behluli, KOMF; Edita Kusari, Blerta Bejtullahu dhe Shaban Murturi, EUSR/EV; Amire Qamili, Birn; Gzim Shala, IKD/BPD; Sanije Berisha, OSBE; Muhamed Shehu, Kosova Sot, Agim Maraj, British Embassy; Rezarta Reka dhe Veli Hoti, UNDP; Artan Demahasaj, ÇOHU; Artan Murati, KDI; Blerim Kelmendi, Afrim Atashi dhe Shaip Havolli, AKK dhe Luljeta Plakolli, Projekti i BE-së.

Mbledhjen e kryesoi, Albulena Haxhiu, kryetare e Komisionit.

Nga staffi mbështetës: Visar Krasniqi, Mirlinda Kolgeci dhe Fatbardha Boletini.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 20.2. dhe 27.2.2018;
3. Shqyrtimi i Raportit me amendamente për Projektligjin nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim;

4. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL për Projektligjin nr. 06/L-001 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-31 për Liritë Fetare në Kosovë;
5. Diskutim nisur me nismën e Komisionit për hartimin e PL- për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/32 për Familjen i Kosovës;
6. Shqyrtimi i Raportit vjetor i punës së Agjencisë Kundër Korrupsionit për vitin 2017 ;
7. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua me ndryshime duke u hequr nga rendi i ditës Shqyrtimi i Raportit me amendamente për Projektligjin nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim, për tu shqyrtuar në mbledhjen e radhës.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 20.02 dhe 27.02.2018

Kryetarja, konstatoi se komisioni miratoi procesverbalet nga mbledhjet e mbajtura me datë 20.02.2018 dhe 27.02.2018, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL për Projektligjin nr. 06/L-001 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-31 për Liritë Fetare në Kosovë

Kryetarja, paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL për Projektligjin nr. 06/L-001, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-31 për Liritë Fetare në Kosovë dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit të deklarohen nëse kanë ndonjë vërejtje.

Sami Kurteshi, sqaroi në lidhje me ecurinë e Projektligjit për Liritë Fetare në Komisionin FunkSIONAL dhe tha që tek amendamenti 10, i ka dy propozime, të zëvendësohet numri, nga 50, të bëhet 100 dhe propozimi tjetër është të hiqet paragrafi 2.2 i nenit 7B.

Kryetarja, theksoi se në raport me procedurat nuk është hasur ndonjëherë që të bëhen amendamente në gjuhën serbe.

Hajdar Beqa, tha se ta përkrahim raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL, ndërsa në seancë ne mund të kemi qëndrime tjera sepse vërtet është ligj i ndjeshëm dhe ka amendamente të mira që duhen përkrahur.

Bilall Sherifi, tha se ka një lobim të fuqishëm që mos të përkrahët amendamenti i z. Nait Hasani sepse sipas atyre që janë kundër këtij amendamenti po tentohet të ndërhyhet kundër trashëgimisë kulturore të kishës ortodokse serbe, andaj mendoj se askush nuk mund të ketë monopol në besimin ortodoks. Sa i përket amendamenteve në gjuhën serbe, tha se në Kushtetutë janë edhe gjuha shqipe dhe ajo serbe, janë të barabarta.

Sami Kurteshi, tha se përmirësimi në gjuhën serbe është në përshtatje në gjuhën shqipe. Ndërsa sa i përket kishës ortodokse, tha se është e vetmja kishë e etnizuar sepse ka Autoqefali.

Arben Gashi, tha se Komisioni FunkSIONAL ka gabuar që nuk i ka dhënë përkrahje amendamentit 6, i propozuar nga deputeti Nait Hasani sepse me 100 nënshkrime mund të formohet një bashkësi fetare dhe pse mos të formohet një bashkësi fetare ortodokse shqiptare. Është shkelje e besimit të lirisë fetare nëse ne nuk e lejojmë këtë amendament, ndaj duhet të përkrahet dhe është pikërisht në frymën kushtetuese për lirinë e besimit.

Bilall Sherifi, tha se amendamenti është në pajtim të plotë me frymën kushtetuese, por nuk mund të pajtohem që historia e kishës ortodokse shqiptare të fillojë pasi të miratohet ligji, është krejtësisht e padrejtë, ndaj nuk mund ta përkrah këtë amendament.

Hajdar Beqa, tha se ta përkrahim amendamentin e z. Nait Hasani dhe propozoi që ta votojmë veçanërisht amendamentin 6 dhe në mënyrë specifike për shkak të rëndësisë së tij.

Pas diskutimeve, kryetarja konstatoi se komisioni, njëzëri vendosi që Komisionit FunkSIONAL t'ia paraqes këtë

Rekomandim

1. Projektligji nr. 06/L-001 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.02/L-31 për Liritë Fetare në Kosovë dhe amendamentet e propozuara, janë në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin e Zbatueshëm.
2. Rekomandohet riformulimi i amendamentit 6, i propozuar nga deputeti Nait Hasani.

4. Diskutim nisur me nismën e Komisionit për hartimin e PL- për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/32 për Familjen i Kosovës;

Kryetarja, paraqiti për diskutim nismën e Komisionit për hartimin e PL për ndryshim dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/32 për Familjen i Kosovës dhe kërkoi të deklarohen nëse kanë vërejtje.

Arben Gashi, tha se titulli i projektligjit nuk është në rregull dhe shtoi se nuk duhet të jetë Ligji për Familjen i Kosovës, por Ligji për Familjen sepse familja i përket individit dhe jo Kosovës.

Kryetarja, tha se nuk mund të ndryshohet titulli në këtë fazë, pasi është ndryshim plotësim i Ligjit dhe është rregull që ka një bazë referimi, duke pohuar se plotësisht pajtohem me vërejtjen tënde.

Komisioni vendosi që ta procedojë Projektligjin për ndryshim dhe plotësim të Ligjit nr. 2004/32 për Familjen i Kosovës, për vlerësimin e pajtueshmërisë së Projektligjit me Legjislacionin e Bashkimit Evropian në Drejtorinë për Standardizim, Përafrim dhe Harmonizim Ligjor dhe për vlerësim të kostos financiare të Projektligjit në Drejtorinë për Buxhet dhe Pagesa.

5. Shqyrtimi i Raportit Vjetor i punës së Agjencisë Kundër Korrupsion për vitin 2017;

Albulena Haxhiu, kryetare, paraqiti për shqyrtim Raportin vjetor të punës së Agjencisë Kundër Korrupsion për vitin 2017 dhe ia dha fjalën drejtorit të Agjencisë Kundër Korrupsion për Korrupsion për të paraqitur raportin.

Shaip Havolli, njoftoi Komisionin me të arriturat dhe sfidat që ka ky institucion. Korniza Ligjore në bazë të së cilës Agjencia ka realizuar mandatin e saj është në procedurë të ndryshimit dhe plotësimit. Ligji për parandalimin dhe Konfliktin e Interesit, është miratuar nga Kuvendi dhe pritet dekretimi nga Presidenti. Po ashtu, tha se jemi duke punuar për Ligjin e Agjencisë dhe Ligjin për Deklarimin dhe Prejardhjen e Pasurisë. Sa i përket ligjit për Agjencinë Kundër Korrupsion, hetimet paraprake sërish do të jenë dhe ato vetëm do të fuqizohen. Do të shtohet vlerësimi i rrezikut nëpër sektorë, ku agjencia do të ketë të drejtën të bëjë vlerësimin e vet, po ashtu, edhe të monitorimit të Strategjisë Kundër Korrupsion, ku me ligjin e ri planifikohet që strategjinë Kundër Korrupsion ta hartojë vetë Qeveria, kurse Agjencia Kundër Korrupsion, të merret me monitorim të Strategjisë dhe të Planit të Veprimit. Planifikohet që Agjencia Kundër Korrupsion ti monitorojë planet e integritetit të institucioneve, duke hartuar një metodologji të njëjtë me Ministrinë e Administratës Publike. Po ashtu, planifikohet, që të bëhet vlerësimi i ligjeve dhe hartimi konform standardeve ndërkombëtare, me ç'rast do të ketë një metodologji të kontrollimit kundër korrupsion të legjislacionit, ku para se të shkojnë në Qeveri, qoftë ligje apo rregullore, së pari do të dërgohen në Agjencinë Kundër Korrupsion, ndërsa pjesë e Zyrës Ligjore do të jenë përfaqësues nga Agjencia Kundër Korrupsion, nga vetë propozuesi i projektligjit, Zyra e Kryeministrit, Zyra e Presidentit dhe Ministrisë së Drejtësisë. Ndërkaq, do të qartësohet edhe situata rreth shqyrtimit të raporteve vjetore të financimit të partive politike, ku do të specifikohet edhe roli i Agjencisë Kundër Korrupsion. Ndërkohë, pritet të hartohet shumë shpejt edhe Ligji mbi Sinjalizues, ku edhe Agjencia Kundër Korrupsion pritet të ketë rolin e saj, nëse një gjë e tillë do të jepet nga Ministria e Drejtësisë apo e grupi punues. Sa i përket Ligjit për Deklarimin dhe Prejardhjen e Pasurisë, planifikohet zgjerimi i listës së zyrtarëve të lartë publikë, sepse shumë institucione dhe zyrtarë janë të ekspozuar ndaj korrupsionit, por nuk gjenden në listën e Deklarimit të Prejardhjes së Pasurisë. Po ashtu, është paraparë, që zyrtarët e lartë janë të obliguar që të deklarojnë krypto- valuta ose paranë virtuale edhe pse nuk janë të legalizuara. Gjithashtu, me kë ligj do të parashihet saktësia e pasurisë, rregullimi i vlerës së pasurisë së paluajtshme dhe luajtshme, xhirollogaritë e subjekteve të hetimeve, përshkallëzimi i sanksioneve dhe të rregullohet që prokuroria të mos i hedh rastet kur shkojnë në mungesë të elementit me dashje, ku qëllimi është që të jetë funksional ky ligj. Për vitin 2017, Agjencia Kundër Korrupsion ka zhvilluar hetime paraprake për 357 raste, ku 45 prej tyre janë bartur nga viti paraprak, kurse në vitin 2017, janë pranuar 312 raste. U tha se 109 raste janë dërguar për kallëzim penal të përcjella në Prokurori dhe në polici për procedim të mëtejme; 18 raste janë për shkelje administrative, me kërkesë për fillim të shkeljes së procedurës disiplinore,

92 raste janë mbyllur, 139 raste janë nën hetime, kurse janë trajtuar 85 informacione anonime. Gjatë këtij viti, Agjencia ka trajtuar 224 raste, ndërsa z. Havolli potencoi se rastet e dërguara në prokurori i përkasin veprave penale, mosdeklarim i pasurisë, deklarim i rremë dhe deklarim pas afatit, keqpërdorim i pozitës zyrtare dhe autoritetit dhe konflikt interesi. Sa i përket deklarimit të pasurisë për vitin 2017, kanë qenë të obliguar të bëjnë deklarimin 6242 zyrtarë lartë publikë, ndërsa për 2016, kanë qenë të obliguar 4670 zyrtarë, kurse 886 zyrtarë i janë nënshtruar kontrollit të plotë, 563 raste nuk është vërejtur ndonjë ndryshim, në 343 raste janë vërejtur ndryshime dhe janë kërkuar sqarime nga zyrtarët e lartë, duke pohuar se 115 raste janë proceduar për hetime të mëtejme dhe 1 rast është përcjellë në Administratën Tatimore. Sa i përket deklarimit të dhuratave, u tha se 11 institucione kanë deklaruar se kanë pranuar dhurata, ndërsa 36 institucione tjera kanë deklaruar se nuk kanë pranuar dhurata. Për fushën e prokurimit publik, janë identifikuar 48 raste për shkelje ligjore me elemente korruptive në aktivitete e prokurimit, janë dhënë 14 opinione, 22 raste janë të mbyllura dhe janë dhënë edhe 7 këshilla. Sa i përket konfliktit të Interesit, janë trajtuar 166 raste. Në 79 raste prej tyre është i janë shmangur konfliktit të interesit, 21 raste janë realizuar pa konflikt interesi, 31 raste janë në procedurë për hetime të mëtejme, 1 rast është iniciuar si kundërvajtje, kërkesë për shkarkim dhe janë dhënë 34 opinione. Bashkëpunimi me institucionet tjera të zbatimit të ligjit ka vazhduar, kurse plani i rishikuar i planit të veprimit 2013-2017 ka dhënë një total prej 120 veprimeve, ku pikat e kontaktit gjatë periudhës raportuese, nuk kanë raportuar fare për 30 veprime. Ndërsa, për Strategjinë Kundër Korrupsion 2018-2022, është miratuar nga Qeveria dhe tani pritet që të miratohet edhe në Kuvend. Në fund vlen të theksohet se sipas Transparency International, Kosova është renditur disa vende më lartë, si e 85-ta në vitin 2017, dhe edhe Raporti i Progresit Agjencinë Kundër Korrupsion e nxjerr institucion të besueshëm, që i ka përmbush aktivitetet e veta.

Kryetarja, tha se sa i përket strategjisë Kundër Korrupsionit do ishte mirë që ne të marrim si praktikë Kroacinë, e cila e ka të rregulluar shumë mirë, ku ministria e Drejtësisë e përpilon strategjinë, ndërsa Kuvendi ka një komision të veçantë i cili përbëhet nga pozita dhe opozita e cila ka një rol dominues dhe po ashtu në përbërje janë shoqëria civile, profesor universiteti dhe një gazetar të cilët zgjidhen me konkurs. Pra, e bëjnë mbikëqyrjen e strategjisë Kundër Korrupsion. Znj. Haxhiu pyet se kush e kontrollon pasurinë zyrtarëve të Agjencisë Kundër Korrupsion sepse në Komision ju nuk i keni sjellë formularët dhe cilat janë veprimet që do të ndërmerrni për hedhjen poshtë të kallëzimeve penale. Po ashtu a ka mundësi që Agjencia të ketë qasje në financat e subjekteve politike dhe si mund të adresohet.

Veprat penale të korrupsionit përbëjnë veprat më të mëdha, por janë veprat që më së paku janë shqiptuar dënime me burg, përveç se me gjobë deri në 2000 euro dhe me kusht 2 muaj deri në 6 muaj. Shqetësuese janë aktgjykimet liruese, refuzuese të dhëna nga gjykata, duke pohuar se në Raportin e Progresit, thuhet se kallëzimet penale që i përpilon Agjencia duhet të jenë më cilësore, ndaj a do të ndërmerrni veprime?

A mundet Agjencia të ketë qasje në shpenzimet dhe të hyrat e financave të partive politike dhe si mund të adresohet kjo çështje? A ka mundësi agjencia të ketë rol të filtrimit në përzgjedhjen e anëtarëve të bordeve në grupin e ngushtë të propozuesve, sepse ka shumë raste që anëtarët e

bordeve të kenë konflikt interesi. A keni pasur mundësi të bëni vlerësim të gjithë zyrtarëve të lartë kontrollin e pasurisë që nga koha e themelimit, sepse shorti nuk është treguar shumë efikas në luftën e krimit të organizuar dhe korrupsionit dhe si është bashkëpunimi me bankat, kadastrën dhe institucione tjera dhe a keni pengesa gjatë punës që ju bëni?

Shaip Havolli: Agjencia ka bërë një vlerësim të dy strategjive paraprake dhe strategjisë së fundit dhe ka vlerësuar se është e domosdoshme që strategjinë Kundër Korrupsion ta hartojë Qeveria. Në strategjinë e re i kemi dhënë një rol më të madh shoqërisë civile si mekanizëm kontrollues, duke i hequr nga lista e aktiviteteve dhe objektivave.

Sa i përket deklaramit të pasurisë të zyrtarëve të Agjencisë, në atë kohë nuk ka funksionuar Kuvendi, prandaj edhe nuk janë dërguar aplikacionet. Për vitin 2017, të gjitha rastet që kemi dërguar me kallëzim penal, pothuajse janë ngrit aktakuza dhe duket që ka një përparim.

Sa i përket opinioneve në fushën e prokurimit publik, gati të gjitha opinionet që i kemi dhënë për vitin 2017, kanë vepruar sipas autoritetit të Agjencisë. Ndërsa tek përzgjedhja e anëtarëve të bordeve, ne duhet ti kemi deklaratat e pasurisë për të vërtetuar se a ka konflikt interesi, gjë që është e vështirë të dihet. Me ligjin e ri planifikohet që zyrtarët e lartë duhet të dëshmojnë prejardhjen e pasurisë. Gjithashtu edhe bashkëpunimi me institucionet tjera është shumë i mirë dhe nuk është paraqitur asnjë problem.

Bilall Sherifi, pyeti se kur prokuroria i hedh poshtë kallëzimet penale a janë formulime jo cilësore apo nuk ka prova të mjaftueshme, apo ka mungesë të gatishmërisë së prokurorisë për të vazhduar më tej.

Shaip Havolli, tha se në shumicën e rasteve prokuroria kërkon informacione shtesë për provat që i kemi dërguar, të cilat janë rreth deklaramit të pasurisë, por ka raste që kërkojnë edhe vlerësim të pronës gjë që Agjencia nuk bën vlerësim të pronës, duke i dhënë sqarime që kjo bëhet me ekspertizë. Së fundi, kemi kërkuar nga prokuroria që mos të hidhet asnjë kallëzim penal pa u konsultuar me ne paraprakisht dhe në këtë drejtim vlerësoj që ka përparim.

Sami Kurteshi, kërkoi sqarim rreth kallëzimeve penale të paraqitura nga AKK-ja, të cilave iu ka kaluar afati i ndjekjes penale ose është bërë parashkrimi i veprës penale dhe çështja tjetër ku prokurorët janë tërhequr nga aktakuza, fillimisht sepse i ka refuzuar Gjykata. Korrupsioni në Kosovë konstatohet se nuk ka fushë apo organizim institucional që nuk ka korrupsion. Po ashtu, korrupsionin si e interpretoni si fakt apo si perceptim?

Hajdar Beqa, tha se në secilin vit Agjencia duket që ka përparim krahasuar me vitet paraprake. Edhe vonesa për një ditë për dorëzim të formularit ka qenë kallëzim penal, gjë që është e pakuptimtë dhe a keni menduar që me ligjin e ri, kallëzimi penal të ketë më shumë të mjaftueshme që mos të njolloset edhe puna zyrtarëve. Po ashtu, a keni menduar që me ligjin e ri të hiqen asamblistët në deklaramit të pasurisë sepse konsideroj që ata nuk kanë paga shumë të mëdha.

Z. Beqa sqaroi se në lidhje me zgjedhjen e anëtarëve të bordeve, ligji e përcakton shumë qartë se kush mund të zgjidhet, ndërsa pyeti se a është e drejtë që paraja virtuale të deklarohet përderisa nuk është e rregulluar me ligj?

Arben Gashi, tha se meqenëse jemi në proces të rishikimit të sistemit, ne në një fazë tjetër do të jemi të përfshirë në lidhje me ligjin që po punohet, kur edhe do të vjen në Kuvend. Shqetësimi i

z. Gashi ishte edhe emri i Agjencisë, ku tha se në fakt Agjencia Kundër Korrupsion është më shumë Agjenci për Krahësim dhe Verifikim të Pasurisë së Zyrtarëve të Lartë Shtetërorë, ndërkohë që me short bëni kontrollin e pasurisë të një zyrtari të lartë, bëhet lajm sikur po hetohet enkas pasuria e zyrtarit të lartë dhe në këtë kuptim duhet të shihet në ligj edhe kjo çështje, që mos të krijohet një dëm i panevojshëm.

Bahrim Shabani, tha se Agjencia Kundër Korrupsion ju mundëson dhe i njofton duke i dhënë mundësi që vet qytetari ti lajmërojë rastet e dyshimta në thirrjet pa pagesë, postë dhe përmes adresës elektronike, po ashtu edhe përmes thirrjeve anonime që të mbrojnë dinjitetin e qytetarit i cili lajmëron rastet e korrupsionit. Ndërkaq z. Shabani pyeti se janë të motivuar qytetarët me rastin e lajmërimit anonim për rastet e korrupsionit dhe sa jeni ju të kënaqur me lajmërimin e qytetarëve për rastet e korrupsionit.

Blerim Kelmendi, tha se sa i përket pyetjes, transparencja e financave të subjekteve politike në bazën aktuale në fuqi e kemi pas një kompetencë që raportet e audituara të financave të partive politike dhe fushatave të tyre, t'i marrim në trajtim pasi të auditohet dhe KQZ-ja ka qenë e obliguar për ti përcjellë këto raporte në Agjenci. Ligji aktual është në plotësim ndryshim, ku ne jemi pjesë e grupit të punës me Zyrën e Kryeministrit dhe aty sërish ka mbetë që kjo kompetencë e Agjencisë Kundër Korrupsion, që pas auditimit të shqyrtohen këto raporte.

Nuk kemi kompetencë të mjaftueshme për qasje në llogari bankare, prandaj kemi propozuar në grup të punës, që do të ishte problem që këto raporte të kontrollohen vetëm nga ana e Agjencisë ose të parashihen kompetenca shtesë për Agjencinë, që të ketë qasje në llogaritë bankare.

Sa i përket cilësisë së kallëzimeve penale nga viti 2006 deri në vitin 2018, nuk është e njëjtë, por si duket ka ngërçe tek prokuroria për faktin se arsyetimet dhe hedhjet poshtë të kallëzimeve penale vazhdojnë të mbesin të njëjta. Po ashtu të gjitha pretendimet që ne i japim në kallëzimin penal të gjitha verifikohen edhe njëherë, kjo për faktin se Kodi i Procedurës Penale nuk e ka parë Agjencinë si organ që merret me hetime. Gjithashtu Gjykata ka dhënë edhe 47 aktgjykime dënuese në bazë të kallëzimeve penale të Agjencisë. Do të duhej të bëhej një vlerësim i kallëzimeve penale, si janë trajtuar në prokurori dhe të dalim me një konstatim të saktë të gjendjes.

Sami Kureshi, pyeti se a janë parashkruar rastet dhe çfarë rastesh janë parashkruar?

Blerim Kelmendi, tha se njëra prej arsyeve të parashkrimeve të ndjekjeve penale është se një vepër penale është dyshuar për periudha të mëhershme kohore dhe e njëjta ka ndodhur ndër vite dhe sanksioni i veprave penale e prek parashkrimin e ndjekjes penale në këto raste. Në lidhje me pyetjen z. Kurteshi, tha se nuk kemi bërë analizë se cilat prej rasteve parashkruhen të zyrtareve të nivelit të lartë apo të atyre më të ulët.

Shaip Havolli, tha se në lidhje me raportimin e rasteve të gjithë ata që raportojmë rastin në Agjenci, marrin informacionin kthyes se kur rasti përfundon. Shumë raste që inicion Agjencia në mungesë të kompetencave, rasti kalon edhe në polici apo edhe në prokurori, duke e bërë më të besueshëm këtë Agjenci.

Duke ju përgjigjur pyetjes së z. Beqaj në lidhje me deklarimin e pasurisë pas afatit, tha se nuk është qëllimi i Agjencisë që ti penalizojmë zyrtarët e lartë dhe të rritet niveli i krimit në vendin tonë në raport edhe me institucionet vendore dhe ndërkombëtare sepse ato janë edhe statistika, por deri tani ne kemi marrë edhe arsyeime nga zyrtari i lartë për mosdeklarim në kohë të pasurisë,

prandaj është paraqit edhe si shqetësim në grupin e punës që kjo çështje të rregullohet. Sa i përket deklarimit të pasurisë nga asamblistët komunalë, ne kemi propozuar që ata të hiqen nga deklarimi i pasurisë të zyrtarëve të lartë. Po ashtu, u tha se vërtet kriptovaluta nuk është e rregulluar me ligji, për këtë çështje duhet të marrim vlerësimin nga Banka Qendrore e Kosovës dhe Administrata Tatimore e Kosovës.

Albulena Haxhiu, kryetare, tha se është e rëndësishme të bëhet analiza e parashkrimit të ndjekjeve penale. Sa i përket auditimit është dashur të bëhet përpjekje që auditimi i financave i partive politike, të jetë kompetencë e Agjencisë Kundër Korrupsionit. KQZ – ja në vazhdimësi ka refuzuar që të ketë kompetencë me arsyetimin që nuk kanë kapacitete.

Po ashtu, Haxhiu i përgëzoi në lidhje me opinionin e vendimit për rritjen e pagave të Qeverisë për trajtim profesional dhe po ashtu edhe për vendimin e fundit për Ligjin për Amnisti, ku është theksuar se kushdo që ka proces gjyqësor për rastin e gazit lotsjellës ka konflikt interesi. Cili do të jetë veprimi juaj në qoftë se ky vendim nuk pezullohet.

Pas diskutimeve, *kryetarja konstatoi se Komisioni, me 4 vota për, 1 votë kundër dhe 1 abstenim nxori këtë:*

Rekomandim

Të miratohet Raporti i Punës së Agjencisë Kundër Korrupsionit për vitin 2017.

6. Të ndryshme

Në këtë pikë u vendos që të formohet grupi i punës për shqyrtimin e Projektligjit nr. 06/L-030 për Aktet Juridike në këtë përbërje:

Hajdar Beqa, kryesues
Albulena Haxhiu, anëtare
Korab Sejdiu, anëtar dhe
Bahrim Shabani, anëtar

Mbledhja përfundoi në orën 13:00.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Albulena Haxhiu